



# **PA**NDËSHKUESHMËRIA

## **në procedimet disiplinore të gjyqtarëve**


Analizë e disa prej shkaqeve që stimulojnë pandëshkueshmërinë në veprimtarinë e **Këshillit të Lartë të Drejtësisë**

**PER VITIN 2015**



FONDACIONI  
SHOQËRIA  
E HAPUR  
PËR SHQIPËRINË

Mars 2016



RESPUBLICA

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Qendrës Res Publica dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton opinionin e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

Grupi i punës:

Av. Dorian Matlija

Av. Arbësa Kurti

Dr. Irena Dule

Theodoros Alexandridis

Botues: Qendra “Res Publica”

Redaktor: Dorian Matlija

# **PANDËSHKUESHMËRIA**

## **në procedimet disiplinore të gjyqtarëve**

Analizë e disa prej shkaqeve që stimulojnë pandëshkueshmërinë në veprimtarinë e **Këshillit të Lartë të Drejtësisë**

**PER VITIN 2015**

# PËRMBAJTJA

## 5 Hyrje

---

## 7 Metodologjia

---

## 9 Reflektimi i rekomandimeve të mëparshme nga Res Publica për KLD

---

## 13 Reforma në Drejtësi dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë

---

13 Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (2015)

---

14 Opinioni i ndërmjetëm i Komisionit të Venecias

---

## 17 Procedimet disiplinore të shqyrtuara nga KLD gjatë vitit 2015

---

17 Shqyrtimi i kërkesave

---

19 Masat disiplinore të propozuara nga Ministri i Drejtësisë

---

23 Shkeljet e konstatuara

---

24 Kërkesat e depozituara nga Ministri i Drejtësisë gjatë vitit 2015

---

25 Mosveprimi i Ministrisë së Drejtësisë

---

26 Imuniteti ndaj procedimit disiplinor të gjyqtarëve, anëtarë të Kolegjit Zgjedhor

---

27 Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive

---

28 Mosrespektimi i afatit të shqyrtimit nga KLD

---

## 29 Raporti i institucionve të tjera me KLD

---

29 Inspektoriati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë

---

30 Avokati i Popullit

---

## 31 Transparenca e Këshillit të Lartë të Drejtësisë

---

## 33 Konkluzione & Rekomandime

---

33 Konkluzione

---

34 Rekomandime

---



# 1. HYRJE

Viti 2015 ka qenë një vit aktiv sa i takon çështjeve të drejtësisë në vend. Reforma në Drejtësi në qendër të diskursit politik dhe të veprimtarisë parlamentare i ka dhënë një vëmendje të posaçme edhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), si organi i nivelit më të lartë dhe më i rëndësishmi i sistemit të Drejtësisë.

Posaçërisht nga mazhoranca e tanishme janë bërë publike pakënaqësitë e saj lidhur me veprimtarinë e KLD, e cila ka bërë përpjekje për të ushtruar ndikim të mëtejshëm mbi këtë organ, me qëllim përmirësimin e punës së tij. Nga ana tjetër, sipas opozitës, reforma nuk synon përmirësimin e punës së institucioneve të drejtësisë, por zotërimin dhe kontrollin e tyre nga ana e mazhorancës qeverisëse.

Ndërsa është e vërtetë që Këshilli i Lartë i Drejtësisë duhet të reformohet, një reformë e tillë nuk duhet të ndodhë thjesht për të adresuar interesat që përputhen me linjën ditore të politikave partiake. Në këtë kontekst është e rëndësishme që mes zërave të njëanshëm me ngjyresa partiake, të spikasë edhe zëri i shoqërisë civile, i cili duhet të vijë me një raportim të paanshëm, me synimin e vetëm që të përmirësojë funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për të bërë atë më të pavarur dhe më efektiv për një shoqëri demokratike.

Qendra Res Publica ka ndjekur nga afër punimet dhe diskutimet për Reformën në Drejtësi, ku një vend të rëndësishëm ka zënë edhe diskutimi për riorganizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për të cilin Res Publica ka vënë në dispozicion të Komisionit Parlamentar për Reformën në Drejtësi rekomandimet dhe opinionin e saj, në lidhje me disa aspekte të reformimit të këtij organi.

Rekomandimet janë mbështetur në studimin e mëparshëm “Pandëshkueshmëria në procedimet disiplinore të gjyqtarëve: Analizë e disa prej shkaqeve që stimulojnë pandëshkueshmërinë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë,” të publikuar nga Res Publica në Maj 2015. Një pjesë e këtyre rekomandimeve gjetën pasqyrim edhe në “Analizën e Sistemit të Drejtësisë”, përgatitur nga Komisioni Parlamentar për Reformën në Drejtësi dhe komisioni ad-hoc, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, i ngritur në Qershor 2015.

Në vazhdimësi, dhe nën dritën e studimit të sipërpërmendur, me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Res Publica ka vazhduar monitorimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë edhe për vitin 2015, në lidhje me transparencën, procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve, përballjen e këtij institucioni me fenomenet korruptive në gjyqësor, etj.

Duke pasur si qëllim, jo vetëm monitorimin e procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve, Res Publica e ka bazuar këtë studim edhe në vëzhgimin e përfshirjes dhe adoptimit nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, të rekomandimeve të prezantuara dhe që janë vënë në dispozicion nga studimi i mëparshëm.

Synimi i qendrës Res Publica është që rezultatet e nxjerra nga ky monitorim të shërbejnë jo vetëm si kritikë e veprimtarisë së KLD në fushën përkatëse, por edhe për të mbështetur rekomandime të tjerë të vlefshme në kuadër të reformës për drejtësi, në procesin e konsultimit publik, pjesë e të cilit është edhe Res Publica.



## 2. METODOLOGJIA

Me qëllim monitorimin e veprimtarisë së KLD lidhur me procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve për vitin 2015 është përdorur e njëjta metodologji me atë të zgjedhur në studimin e mëparshëm, “Pandëshkueshmëria në procedimet disiplinore të gjyqtarëve” për vitin 2014, në vazhdimësi të të cilit është bërë edhe ky monitorim. Kjo do të ndihmojë në krahasimin e rezultateve të nxjerra midis dy viteve për veprimtarinë e KLD në lidhje me procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve.

Konkretisht, burimi i parë i informacionit është marrë nga faqet web të institucioneve dhe mediave të ndryshme, si faqja zyrtare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministrisë së Drejtësisë, Avokatit të Popullit, Kuvendit etj. Në mënyrë të veçantë janë monitoruar dhe shqyrtuar vendimet dhe procesverbalet për periudhën Janar 2015 - Janar 2016<sup>1</sup> të publikuara në faqen web të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Res Publica ka kërkuar informacion të mëtejshëm nga disa autoritete publike lidhur me problematikën e konstatuara.

Njëkohësisht janë ndjekur edhe zhvillimet e fundit në kuadër të reformës për drejtësi si dhe raportet e hartuar nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, në lidhje me veprimtarinë e KLD-së, për vitin 2015.

---

<sup>1</sup> Një pjesë e shqyrtimeve që i përkasin vitit 2015 kanë përfunduar në muajin Janar 2016 dhe janë bërë pjesë e monitorimit për vitin 2015.



### 3. REFLEKTIMI I REKOMANDIMEVE TË MËPARSHME NGA RES PUBLICA PËR KLD

Në raportin e publikuar nga Res Publica me titull “Pandëshkueshmëria në procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve. Analizë e disa prej shkaqeve që stimulojnë pandëshkueshmërinë në veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, u parashtruan disa rekomandime, të cilët pjesërisht janë reflektuar, por disa të tjera nuk janë reflektuar ende, siç paraqiten në vijim:

*1. Nisma për procedimin disiplinor të mos jetë kompetencë ekskluzive e Ministrit të Drejtësisë.*

Ky rekomandim mund të përmbushet me rregullime ligjore e deri në këtë moment nuk mund të reflektohet në ushtrimin e kompetencave të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Megjithatë, në Analizën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri është theksuar që mekanizmi i nismës disiplinore ekskluzive nga Ministri i Drejtësisë nuk ka rezultuar efektiv dhe ka perceptime të mungesës së objektivitetit dhe profesionalizimit në ushtrimin e kësaj kompetence, aq më tepër në rrethanat kur vetë nisma për inspektimin dhe rezultatet e tij janë nën përgjegjësinë direkte të Ministrit.<sup>2</sup> Përqendrimi i kompetencës ekskluzive për të filluar procedimin gjyqësor ndaj një gjyqtari në dorë të Ministrit të Drejtësisë bie ndesh me standartet e BE-së dhe nuk përbën garanci në drejtim të paanshmërisë që duhet të ketë Ministri i Drejtësisë në të gjitha rastet e ndëshkimit të gjyqtarëve.<sup>3</sup>

Sa më sipër rezulton se hapi i parë i përshtatjes të këtij shqetësimi është hedhur dhe duket se ka një prognozë të mirë që ky rekomandim të gjejë rrugën e tij deri në finalizimin e masave të posaçme legjislative gjatë procesit të Reformës në Drejtësi.

<sup>2</sup> Shih “Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri, që gjendet në: [http://www.drejtesia.gov.al/files/userfiles/Analiza\\_e\\_sistemit\\_te\\_drejtjesise\\_FINAL/Analiza\\_e\\_sistemit\\_te\\_drejtjesise\\_FINAL.pdf](http://www.drejtesia.gov.al/files/userfiles/Analiza_e_sistemit_te_drejtjesise_FINAL/Analiza_e_sistemit_te_drejtjesise_FINAL.pdf)

<sup>3</sup> Po aty, fq 30

2. Në rast tërheqjeje nga autoriteti që nis procedimin disiplinor (aktualisht Ministri i Drejtësisë), KLD dubet ta përfundojë vetë atë dhe jo ta pushojë procedimin, siç ka vepruar.

Gjatë monitorimit të vendimarrjes së KLD në lidhje me masat disiplinore ndaj gjyqtarëve është vënë re që gjatë vitit 2015 nuk ka pasur raste kur Ministri i Drejtësisë të ketë kërkuar pushimin e çështjes. Për këtë arsye nuk qe e mundur që gjatë vitit 2015 të verifikohet përshtatja e këtij rekomandimi.

3. Nëse gjyqtarët, me një vendim të arsyetuar dhe të mbështetur në jurisprudencën e GJEDNJ, nuk zbatojnë një Vendim Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të mos ndëshkohen a priori me shkarkim nga detyra.

Lidhur me këtë rekomandim nuk është verifikuar asnjë rast procedimi disiplinor për këtë shkak gjatë veprimtarisë së KLD-së në vitin 2015. Për këtë arsye reflektimi i këtij rekomandimi nuk mund të verifikohet.

4. Masa disiplinore “dërgimi në një gjykatë tjetër një deri në dy vjet” është e papërshtatshme dhe dubet të rishikohet.

Edhe ky rekomandim nuk është reflektuar për shkak se gjatë vitit 2015 nuk është verifikuar asnjë kërkesë për fillim të procedimit disiplinor me këtë objekt. Por, këtu vlen të theksohet se në vitin 2014 nga Ministri i Drejtësisë kjo masë është kërkuar 5 herë, ndërkohë moskërkimi i kësaj mase në vitin 2015 shfaq reflektimin në praktikë ndaj këtij rekomandimi.

5. Afati për dërgimin e gjyqtarit për procedim disiplinor rekomandohet të jetë më i shkurtër se 1 vit., si dhe Inspektoriat i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Inspektoriat i Ministrisë së Drejtësisë të bashkohen në një strukturë të vetme.

Për të adresuar këto dy rekomandime nevojiten ndërhyrje në ligj dhe ende nuk ka nisur faza e propozimit të masave të posaçme legjislative, për të parë qëndrimin e Komisionit Parlamentar të Reformës në Drejtësi.

6. Të bëhen publike raportet e zbatimit të memorandumeve të mirëkuptimit.

Ky rekomandim nuk është reflektuar ende. Bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit, memorandumet e mirëkuptimit dhe raportet e zbatimit të tyre mund të ishin pjesë e atyre informacioneve që bëhen publike pa kërkesë, duke u publikuar në rubrikën e veçantë të programit të transparencës.

Megjithatë, programet e transparencës së çdo autoriteti publik janë ende në fazat e kolaudimit, pasi, siç konstatohet edhe nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit në raportin e tij për vitin 2015, shumë autoritete publike ende nuk e kanë zbatuar këtë kërkesë të ligjit. Vlen të theksohet se transparenca e KLD-së gjatë vitit 2015 është përmirësuar ndjeshëm.

7. *Nëse afati 1 vjeçar nuk ka skaduar ende, të nisë procesi i verifikimit të rasteve të lëna pezull*

Në monitorimin e vitit 2014 u konstatuan 5 raste kur procedimi disiplinor nuk ishte nisur, ndërkohë që rrezikohej të digjej afati 1 vjeçar. Për disa prej këtyre rasteve Ministria e Drejtësisë u shpreh se inspektorët e KLD kishin humbur dosjet e inspektimeve duke e bërë të pamundur dërgimin e rasteve në KLD brenda afatit. Ministria e Drejtësisë bëri një kallëzim penal për dosjet e humbura, por nga informacioni zyrtar i dhënë nga Prokuroria e Rrethit Tiranë rezulton se procedimi u pushua për shkak se dosjet nuk kishin humbur, dhe se ishte në diskrecionin e Ministrit të Drejtësisë që të nisëj kërkesa për procedim disiplinor në KLD. Nga ana e Ministrisë së Drejtësisë nuk është dërguar në KLD asnjë nga rastet e konstatuara nga Res Publica, megjithë kalimin e afatit ligjor. Kjo vlen edhe për rastet e raportuara nga Inspektoriati i Lartë i Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), të cilat gjatë vitit 2014 nuk patën sukses për arsye të mungesës së komunikimit mes këtij autoriteti dhe KLD-së.

8. *Në rastet kur KLD nuk pranon kërkesën për procedimin disiplinor të gjyqtarëve për shkak se shkelja është shumë e lehtë dhe procedimi ka nisur në bazën e një inspektimit të Inspektoriatit të Ministrisë së Drejtësisë, ky i fundit të referojë çështjen tek Inspektoriati i KLD-së, për të ekzekutuar masat e posacme në të tilla raste.*

Gjatë vitit 2015 nuk rezulton të jetë marrë parasysh ky rekomandim. Megjithatë, në takimin e zhvilluar me rastin e prezantimit të studimit “Pandëshkueshmëria në procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve. Analizë e disa prej shkaqeve që stimulojnë pandëshkueshmërinë në veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë u shprehën se në pak raste nga 66 rastet e raportuara nga Ministri i Brendshëm, ishin konstatuar shkelje të lehta, për të cilat synohej të përfshiheshin në dosjet e gjyqtarëve përkatës.



# 4. REFORMA NË DREJTËSI DHE KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

## 4.1. Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (2015)

Në kuadër të Reformës në Drejtësi, zhvillimi më i rëndësishëm gjatë këtij viti ka qenë publikimi i Analizës së Sistemit të Drejtësisë, përgatitur nga Komisioni Parlamentar për Reformën në Drejtësi në Qershor 2015.

Analiza mban një qëndrim kritik për disa aspekte të mandatit të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe për mënyrën e funksionimit aktual të këtij organi. Ai mbështetet në rezultatet e nxjerra nga raporte të shumta ndërkombëtare.

Një pjesë e problematikave të raportuara në dokumentin e mësipërm, janë konstatuar dhe në studimin e “Pandëshkueshmëria në procedimet disiplinore të gjyqtarëve” (Maj 2015) të qendrës Res Publica.

Një prej tyre i referohet të drejtës ekskluzive të Ministrit të Drejtësisë për të iniciuar procedimin disiplinor ndaj gjyqtarëve. Sipas raportit, dhënia e një pushteti të tillë ekskluzivisht një organi politik, ngre shqetësime lidhur me ndikimin e mundshëm politik në fushën e drejtësisë dhe nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare.<sup>4</sup>

Në përgjithësi, raporti vlerëson se roli dhe shkalla e përfshirjes së Ministrit të Drejtësisë duhet të rishikohet: Sipas tij: “[...] *ka pasaktësi konceptuale dhe ligjore mbi rolin e Ministrit të Drejtësisë në fushën e qeverisjes së mirë të gjyqësorit, në veçanti në lidhje me sistemin e menaxhimit të rastit, marrëdhëniet me publikun dhe median, menaxhimin e cilësisë dhe sistemin e sigurisë së gjykatës*“.<sup>5</sup>

4 Shih “Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri, që gjendet në: [http://ëëë.drejtësia.gov.al/files/userfiles/Analiza\\_e\\_sistemit\\_te\\_drejtësisë\\_FINAL/Analiza\\_e\\_sistemit\\_te\\_drejtësisë\\_FINAL.pdf](http://ëëë.drejtësia.gov.al/files/userfiles/Analiza_e_sistemit_te_drejtësisë_FINAL/Analiza_e_sistemit_te_drejtësisë_FINAL.pdf), fq. 33, 93, 104.

5 Po aty, fq. 104. Gjithashtu Unioni i Gjyqtarëve është dakort që kompetencat e Ministrit të Drejtësisë duhen reduktuar dhe ai nuk duhet të jetë pjesë e KLGJ-së.

Në këtë Raport theksohet gjithashtu se koordinimi midis Ministrisë së Drejtësisë dhe KLD-së, në fushat ku ato operojnë së bashku (si p.sh në fushën e procedimit disiplinor të gjyqtarëve) nuk është efektiv, si për shkak të mbivendosjes së kompetencave<sup>6</sup>, ashtu edhe për shkak të mungesës së transparencës së veprimtarisë së KLD-së.<sup>7</sup>

Problematik mbetet fakti i mungesës së kompetencës së KLD-së për të marrë masa disiplinore ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, pasi KLD-ja ka juridiksion vetëm për gjyqtarët e shkallës së parë dhe ata të apelit.<sup>8</sup>

Raporti gjithashtu ka qenë kritik ndaj sanksioneve disiplinore që mund të jepen për gjyqtarët, duke pasur parasysh se klasifikimi i tyre i ngurtë dhe mungesa e fleksibilitetit nuk lejon marrjen e masave efektive dhe proporcionale disiplinore.<sup>9</sup>

Njëlloj vlerësohet negativisht edhe dështimi i KLD-së në përfundimin në kohë të vlerësimit të performancës së gjyqtarëve; KLD-ja është ende duke bërë vlerësimin e performancës së gjyqtarëve për periudhën 2007 – 2009.<sup>10</sup>

Megjithatë duhet të theksohet se disa nga këto probleme krijohen për shkak të mënyrës së punës ad-hoc të anëtarëve të KLD-së. Anëtarët të cilët punojnë si gjyqtarë (me përjashtim të zëvendëskryetarit) nuk punojnë në KLD me kohë të plotë dhe as nuk janë të përfshirë në punën e saj të përditshme, por vetëm marrin pjesë në mbledhjet, pasi ata vazhdojnë të ushtrojnë funksionet e tyre në sistemin gjyqësor.<sup>11</sup>

#### 4.2. Opinioni i Ndërmjetëm i Komisionit të Venecias

Me qëllim adresimin e problematikës së paraqitur më sipër, sipas Analizës së Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri është propozuar shkrimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe zëvendësimi i tij me një organ mbikëqyrës, konkretisht me Këshillin e Lartë Gjyqësor. Ky organ i ri sugjerohet të ketë në përbërje më pak anëtarë nga rradhët e gjyqësorit se KLD, (6 gjyqtarë dhe 5 juristë), të cilët do të zgjidhen nga Kuvendi me një shumicë të cilësuar votash prej 3/5.

Sipas Opinioneve të Dhjetorit 2015, Komisioni i Venecias shprehet se një veprim i tillë është i justifikuar dhe zëvendësimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë me Këshillin e Lartë Gjyqësor nuk shihet si një përpjekje e pushtetit ekzekutiv për të ushtruar kontroll mbi gjyqësorin.<sup>12</sup> Megjithatë, Komisioni i Venecias ka qenë kritik në lidhje me rolin që do të luajë Ministri i Drejtësisë në strukturën e re të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Duke rikujtuar Opinioneve e mëparshëm për këtë çështje, Komisioni rithekson se roli i Ministrit të Drejtësisë duhet të qartësohet dhe kompetencat e tij të reduktohen.<sup>13</sup> Gjithashtu është vënë në dukje se Ministri i Drejtësisë nuk duhet të jetë pjesë e Tribunalit Disiplinor, i cili do të jetë organi që do të

6 Po aty, fq. 97 - 98.

7 Po aty, fq. 94

8 Po aty, fq. 98

9 Po aty, fq. 106

10 Po aty, fq. 105

11 Po aty, fq. 103-104

12 Komisioni i Venecias, Opinioni Nr. 824/2015, CDL(2015)052, gjendet në: <http://shqiptarja.com/pdf/neë/Venice%20Commission%20Draft%20Interim%20Opinion%20Dec%204.pdf>, fq.95

13 Po aty, prg. 62



shqyrtojë ankesat e gjyqtarëve lidhur me masat disiplinore të marra ndaj tyre nga Këshilli i Lartë Gjyqësor<sup>14</sup> apo organe të tjera disiplinore.<sup>15</sup>

Në përgjithësi mund të thuhet se Komisioni i Venecias mban qendrimin se ruajtja e pozicionit të Ministrisë të Drejtësisë si një faktor kyç në fushën e administrimit të brendshëm të gjyqësorit, siç rezulton të jetë aktualisht, është në kundërshtim me rekomandimet e raportit të përgatitur nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, të përmendura dhe më sipër.

Përveç sa më sipër, Komisioni i Venecias ka shprehur shqetësimin se ngritja e disa organeve të reja (të tilla si Tribunali Disiplinor i përmendur më sipër ose Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, ku ky fundit do të iniciojë procedurën disiplinore ndaj gjyqtarëve para Këshillit të Lartë Gjyqësor), pa shkrirë më parë ato ekzistueset, krijon mbivendosje të kompetencave.<sup>16</sup>

Sipas Komisionit të Venecias, skema e re duket tepër e komplikuar dhe mund të jetë e vështirë për t'u zbatuar, duke pasur parasysh se numri i kandidatëve të kualifikuar për postet e reja që do të hapen në këto institucione do të jetë i kufizuar në një vend të vogël si Shqipëria.<sup>17</sup> Për më tepër ngritja e këtyre institucioneve do të shoqërohet me shpenzime të mëdha<sup>18</sup> dhe të rënda për buxhetin e shtetit.

14 Po aty, prg. 71, 137

15 Po aty, prg. 80-81

16 Po aty, prg. 67

17 Po aty, prg. 65

18 Po aty, prg. 75




# 5. PROCEDIMET DISIPLINORE TË SHQYRTUARA NGA KLD GJATË VITIT 2015

## 5.1. Shqyrtimi i kërkesave

Gjatë vitit 2015, rezulton që Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka marrë në shqyrtim 11 kërkesa për procedim disiplinor të iniciuara nga Ministria e Drejtësisë, në dallim nga viti 2014, gjatë të cilit KLD ka shqyrtuar 20 të tilla.

**Fig. 1 - Numri i procedimeve disiplinore të shqyrtuara nga KLD në vitet 2014 - 2015**



Vlen të theksohet se procedimet disiplinore të shqyrtuara gjatë vitit 2015 nga KLD janë në bazë të kërkesave të depozituara nga Ministri i Drejtësisë në vitin 2014.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesave, KLD ka marrë këto vendime:


- 5 kërkesa janë pranuar;
- 4 kërkesa janë rrëzuar;
- 1 kërkesë është pezulluar;
- 1 kërkesa është ndryshuar.

Nga kërkesat e ndryshuara, në një rast Ministri i Drejtësisë kishte kërkuar më parë “shkarkim nga detyra” e më pas e zëvendësoi me masën më të butë “vërejtje me paralajmërim”. Megjithatë edhe kjo kërkesë u rrëzua nga KLD-ja, për shkak të parashkrimit të afatit të nisjes së procedimit (1 vit).

Në dy çështjet e tjera KLD-ja nuk ka pranuar 2 kërkesat e Ministrit të Drejtësisë si të papërshtatshme, duke propozuar masa të tjera disiplinore, konkretisht, në një rast masa “shkarkim nga detyra” u zëvendësua me masën “vërejtje me paralajmërim”, e cila u pranua, ndërsa në një rast tjetër masa “vërejtje me paralajmërim” u zëvendësua me masën “vërejtje”, e cila u rrëzua edhe pas ndryshimit të saj.

Të dhënat pasqyrohen në figurën në vijim:

**Fig. 2 - Krahasim i rezultatit të procedimeve disiplinore 2014 - 2015**



Siç vihet re nga grafiku i mësipërm, ka një qendrueshmëri rezultati në dy vitet e monitoruara nga Res Publica, me diferenca të pandjeshme. Në 1/3 e rasteve kërkesat e Ministrit të Drejtësisë janë rrëzuar, ndërkohë që në afro 1/3 ato janë ndryshuar me propozimin e dhënies së masave disiplinore më të lehta. Vetëm 1/3 e kërkesave është pranuar nga KLD sipas kërkesës fillestare të paraqitur nga Ministri i Drejtësisë.

Ndryshimet e bëra në vitin 2014 në Ligjin nr. 8811/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” janë zbatuar nga KLD gjatë procedimeve disiplinore të monitoruara gjatë këtij viti, ndryshe nga situata e monitoruar një vit më parë nga Res Publica (problemet e konstatuara në raportin e parë).

Më konkretisht, gjatë vitit 2014 është konstatuar se pavarësisht se kërkesa e Ministrit të Drejtësisë është rrëzuar si jo proporcionale dhe ky i fundit nuk ka propozuar një masë tjetër, KLD nuk e ka ndëshkuar me një masë tjetër proporcionale gjyqtarin e proceduar, por ka pritur ndryshimin e masës disiplinore nga vetë Ministri i Drejtësisë. Ndërsa gjatë vitit 2015, KLD, në rastet kur e ka gjetur jo proporcionale masën e propozuar nga Ministri i Drejtësisë, ka propozuar vetë një masë më të përshtatshme dhe gjyqtari është ndëshkuar në proporcion me shkëlqen e kryer. Në këtë mënyrë gjyqtarët nuk kanë shpëtuar pa ndëshkim siç ndodhte në vitin 2014. Një gjë e tillë ilustron në shembullin në vijim:

**Shembull 1** - Vendimi nr.20, datë 03.03.2015

Këshilli i Lartë i Drejtësisë konkludon se ....

- i) shkeljet e konstatuara në veprimtarinë gjyqësore të gjyqtari O.A. vlerësohen se kanë shkaktuar shqetësim në një masë të madhe të njerëzve të interesuar, duke dëmtuar besimin e publikut tek dhënia dhe administrimi i drejtësisë, duke ulur imazhin e sistemit gjyqësor, duke prekur interesat e palëve.
- ii) sjellja e gjyqtarit ka diskredituar pozitën dhe figurën e saj, duke dëmtuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

Në analizë të sa më sipër, Këshilli arriti në përfundimin se veprimet e gjyqtarit O.A. gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij gjyqësore, të konstatuara nga Ministri i Drejtësisë janë të tilla që nuk e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore në atë masë për të justifikuar shkarkimin nga detyra e gjyqtarit. Për këtë arsye, duke e vlerësuar kërkesën për “shkarkim nga detyra” si të pabazuar, e rrëzoi atë me shumicë votash. Pas vendimit të Këshillit për rrëzimin e kërkesës dhe masës së propozuar të Ministrit të Drejtësisë për dhënien e masës disiplinore “shkarkim nga detyra” për gjyqtarin e Gjykatës së Shkallës së Parë XX, O.A, bazuar në nenin 26, pika 2 e ligjit “Për organizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, ku është përcaktuar se “Në qoftë se Këshilli i Lartë i Drejtësisë rrëzon masën disiplinore të propozuar nga ministri, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të vendosë një masë më të lehtë”, Këshilli procedoi me propozimin për masën disiplinore të “vërejtje me paralajmërim” në vend të masës “shkarkim nga detyra”, kërkesë e cila u pranua.


Ky është rasti i parë, kur propozimi për masën disiplinore të kërkuar nga Ministria e Drejtësisë është rrëzuar, dhe nga KLD është propozuar një masë tjetër, më e lehtë, e cila është pranuar.

## 5.2. Masat disiplinore të propozuara nga Ministria e Drejtësisë

Në 11 procedimet e shqyrtuara nga KLD për vitin 2015, Ministria e Drejtësisë ka propozuar masat disiplinore të mëposhtme:

- në 7 raste, masën disiplinore “shkarkim nga detyra”
- në 4 raste, masën disiplinore “vërejtje me paralajmërim”

**Fig. 3 - Krahasim i masave disiplinore të propozuara nga MD në vitet 2014 - 2015**



Sa më sipër, konstatohet se ndryshe nga viti 2014 ku vërehej një larmi më e madhe e llojeve të masave të propozuara, në vitin 2015 Ministri i Drejtësisë është kufizuar në propozimin e vetëm dy lloj masash; shkarkimin nga detyra dhe vërejtjen me paralajmërim. Rëndesa e masave disiplinore duket se nuk ka ndryshime të rëndësishme.


Një nga masat disiplinore e cilësuar si e papërshtatshme nga Res Publica në raportin për vitin 2014, ajo e dërgimit në gjykatë tjetër për 1-2 vjet, nuk është kërkuar nga Ministri i Drejtësisë në vitin 2015, ndërkohë që në vitin 2014 kanë qenë 5 kërkesa të tilla. Ky është një zhvillim pozitiv, duke mos zbatuar në praktikë një masë të gabuar që nevojitet të shfuqizohet.

**a. Shkarkimet nga detyra**

Ministri i Drejtësisë ka propozuar marrjen e masës disiplinore “shkarkim nga detyra” në 7 raste , nga të cilat:

- Në 3 raste KLD ka pranuar kërkesën e Ministrit dhe ka vendosur shkarkimin nga detyra të gjyqtarëve.
- Në 1 rast kërkesa është zëvendësuar nga vetë Ministri me masën “vërejtje me paralajmërim.” Kjo kërkesë është rrëzuar më pas nga KLD.
- Në 1 rast është zëvendësuar nga vetë KLD me masën disiplinore “vërejtje me paralajmërim”
- Në 1 rast kërkesa e Ministrit është rrëzuar.
- Në 1 rast kërkesa është pezulluar deri në marrjen e një vendimi nga organi i akuzës, i cili kishte nisur procedim penal në ngarkim të gjyqtarit.

**Fig. 4 - Rezultati i shqyrtimit të kërkesave për “shkarkim nga detyra” në vitet 2014 - 2015**



Nga grafiku i mësipërm vihet re se gjatë vitit 2015 kërkesat e Ministrit të Drejtësisë janë pranuar në një masë më të madhe në krahasim me vitin 2014. Kjo vjen për shkak se gjatë vitit 2014 ka qenë vetë Ministri i Drejtësisë që ka ndryshuar masat duke i zbutur ato dhe duke e vendosur

KLD në pozitë detyruese për të mos marrë masën e shkarkimit nga detyra në disa raste. Por, gjithashtu, gjatë vitit 2015 kërkesat e Ministrit të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra të gjyqtarëve janë rrëzuar në masë më të vogël. Kjo ka ardhur për shkak se disa kërkesa në vitin 2014 janë rrëzuar nga KLD pasi Ministri i Drejtësisë kërkoi shkarkimin e gjyqtarëve pa dorëzuar provat e nevojshme shkresore në rastet e çështjeve që lidhen me deklarimin e pasurive.

Megjithatë, gjatë vitit 2015 konstatohet një rast problematik, për shkak të paraqitjes së kërkesës për procedim nga Ministri i Drejtësisë pas kalimit të afatit 1 vjeçar. KLD vendosi rrëzimin e kërkesës, për shkak të parashkrimit. Gjatë vitit 2014 u konstatuan 5 raste kur Ministri i Drejtësisë nuk nisi fare procedimin brenda afatit 1 vjeçar. Ndërkohë në vitin 2015 konstatohet vetëm një rast, të cilin Ministri e dërgoi në KLD, por me rezultat të parashikuar që më parë.

Kjo konfirmon edhe një herë problematikën e konstatuar edhe në studimin pararendës, ku mosveprimi i Ministrit të Drejtësisë, në kushtet kur kompetenca për nisjen e procedimit disiplinor është kompetencë ekskluzive e tij, bëhet shkak për të “shpëtuar” gjyqtarin, subjekt të procedimit.

#### **Shembulli 2** - Vendimi nr.22, datë 03.03.2015

*Kësbilli vlerëson se kërkesa e Ministrit të Drejtësisë duhet të mbështetet në nenin 34 të ligjit nr. 9877, date 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ku përkundrejt të drejtës që ligji i ka dhënë Ministrit të Drejtësisë për të pasur ekskluzivitet në nsjen e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit, në mënyrë taksative parashikon edhe se e drejta e tij për të ndërmarrë këtë iniciativë nuk është e pakufizuar në kohë. Fillimi i procedimit disiplinor mund të bëhet jo më vonë se 1 vit nga data e konstatimit të shkeljes nga organi që ka të drejtën për fillimin e këtij procedimi, por jo më vonë se 5 vjet nga data e kryerjes së shkeljes.*

*Nisur nga dispozitat e parashikuara nga ligji, Kësbilli vlerëson se kërkesa e Ministrit të Drejtësisë nga momenti i daljes së urdbrit nr. 47, datë 30.01.2013, me të cilin ka nisur dhe është parashikuar data e përgatitjes së raportit deri në dërgimin e këtij procedimi disiplinor nga Ministri i Drejtësisë është një periudhë, përafërsisht 1 viti e 8 muaj, në të cilin është konstatuar shkelja.*

*Në analizë të sa më sipër, Kësbilli arrin në përfundimin se kërkesa e Ministrit të Drejtësisë nr. 3301/5 prot., date 27.10.2014, për procedimin disiplinor të gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, P.A., dhe marrjen ndaj saj të masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” për shkarkim nga detyra është jashtë afatit të parashikuar nga ligji për fillimin e procedimit disiplinor.*

Afati 1 vjeçar është tepër i gjatë për ta humbur, duke e justifikuar me ngarkesën e punës apo me probleme të tjerë të natyrës burokratike.

Nga ana tjetër, një nga rekomandimet e propozuara në studimin e mëparshëm nga Res Publica (Maj, 2015), lidhej me shkurtimin e afatit për nisjen e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit, pasi afati 1 vjeçar është shumë i gjatë dhe krijon hapësirë që gjyqtari të mbetet peng i Ministrit të Drejtësisë për një kohë shumë të gjatë dhe kjo gjendje pezull eventualisht mund të ndikojë në pavarësinë e vendimarrjes së gjyqtarit gjatë kësaj kohe.

Nëse afati do të mund të shkurtohej sipas rekomandimit të mësipërm, atëherë duhet të merren masa serioze për të bërë të mundur, së pari, që procedimin disiplinor të mos e nisë

vetëm Ministri i Drejtësisë, dhe së dyti, organi nismëtar i procedimit disiplinor duhet ta ketë detyrim ligjor nën përgjegjësinë e tij, për të cilin të mund të përgjigjet edhe penalisht nëse është e nevojshme.


**b. Vërejtje me paralajmërim**

Gjatë vitit 2015 nga KLD janë shqyrtuar 4 raste të propozuar nga Ministri i Drejtësisë për marrjen e masës disiplinore “vërejtje me paralajmërim”. Nga këto propozime ka rezultuar se:

- Në 2 raste kërkesa është pranuar nga KLD, e cila ka vendosur masën disiplinore “vërejtje me paralajmërim.”;
- Në 1 rast kërkesa është zëvendësuar nga KLD me masën disiplinore “vërejtje”, por që gjithsesi e ka rrëzuar edhe këtë të fundit;
- Në 1 rast kërkesa është rrëzuar nga KLD.

Të dhënat pasqyrohen në mënyrë grafike në vijim:

**Fig. 5 - Rezultati i kërkesave për “vërejtje me paralajmërim” në vitet 2014 - 2015**



Në njërin rast konstatohet që KLD, pavarësisht se konstaton shkelje në veprimtarinë e gjyqtarit, ka rrëzuar masën e propozuar nga Ministri i Drejtësisë, duke mos propozuar masë më të lehtë, sipas parashikimeve ligjore dhe proporcionalitetit me shkeljen e kryer.

**Shembulli 3 - Vendimi nr.21, datë 03.03.2015**

*Këshilli thekson se jo në çdo rast shkeljet që konstatohen në veprimtarinë e gjyqtarit do të konsiderohen si shkelje që kanë çuar në humbjen e besimit dhe kredibilitetit ndaj gjyqtarit apo akte që kanë diskredituar rëndë figurën dhe sjelljen e tij. Që këto shkelje të konsiderohen si të tilla duhet të ketë një mungesë kujdesi dhe operativiteti, neglizhencë, të tilla që kalojnë “kufirin e të arsyeshmes”, dhe që një sjellje e tillë nuk mund të justifikohet, duke çuar në cenimin e prestigjit të gjyqtarit dhe humbjen e besimit ndaj tij.*



*Nga faktet e parashtruara konstatohet se shkeljet e kryera nga gjyqtarja P.F., nuk përbëjnë shkelje të tilla që pasjellin procedimin disiplinor të saj. Gjyqtarja rezulton se ka pasur ngarkesë tepër të lartë të çështjeve që ka gjykuar për vitin 2013, ngarkesa maksimale në punë, vetëm gjatë vitit 2013 ka gjykuar 563 çështje (vendime themeli përfundimtare), ku përfshihen edhe rastet e vendimeve me vonesa në dorëzimin e arsyetuar të tyre.*

*Duke vlerësuar numrin e shkeljeve, natyrën e tyre, llojin e veprimtarisë gjyqësore ku janë kryer këto shkelje, ngarkesën në detyrë të gjyqtarës, Këshilli çmon se gjyqtarja ka kryer shkelje të disiplinës së gjyqtarit, por se shkeljet e konstatuara, nuk janë të tilla, nuk janë deri në atë shkallë që të përlligji kërkesat për dhënie të masës disiplinore ndaj saj.*

*Në analizë të sa më sipër, Këshilli arrin në përfundimin se veprimet e gjyqtarës P.F. gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj gjyqësore, të konstatuara nga ministri i Drejtësisë, janë të tilla që nuk ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore në atë masë për të justifikuar “Vërejtjen me paralajmërim”. Për sa më sipër, Këshilli, pasi vlerësoi kërkesën e ministrit të Drejtësisë, e rrëzoi atë kërkesë me shumicë votash.*

*Këshilli i Lartë i Drejtësisë, pas vendimit të Këshillit për rrëzimin e propozimit të ministrit të Drejtësisë për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, P.F., nuk propozoi një masë tjetër disiplinore ndaj kësaj gjyqtareje, sikundër parashikohet në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar.*

Vendimi i mësipërm ka mangësi pasi KLD duhej të kishte propozuar së pari një masë disiplinore më të lehtë, siç është “vërejtja” dhe më pas duhej ta kishte marrë në analizë këtë masë nëse ajo do të ishte proporcionale ose jo me shkeljet e konstatuara.

### **c. Autorizimi për veprime procedurale penale dhe pezullimi nga detyra i gjyqtarëve**

Për vitin 2015, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vendosur dhënien e e autorizimeve për arrestimin dhe kontrollin personal për dy gjyqtarë (Vendimet nr. 61/2015 dhe 63/2015), ndërsa në 5 raste ka vendosur pezullimin nga detyra të gjyqtarëve deri në momentin e marrjes së një vendimi nga gjykata (Vendimet nr. 47/2015, 74/2015, 75/2015, 52/2015 dhe 16/2016).


Në diferencë nga viti 2014 kur pati vetëm një rast për dhënie autorizimi, duket qartë se për vitin 2015, ka një rritje të numrit të çështjeve penale të ndjekura nga prokuroria dhe autorizimeve të dhëna nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

### **5.3. Shkeljet e konstatuara**

Disa nga shkeljet e konstatuara nga Ministri i Drejtësisë dhe për të cilat është nisur procedimi disiplinor ndaj gjyqtarëve janë: (1) zvarritje e procesit; (2) mos arsyetimi i vendimit; (3) shkelje të rënda të ligjit; (4) shkelje të rregullave të etikës; (5) deklarimi i pasurisë; (6) për shkak të vendimit penal.

Të dhënat për këto shkelje jepen në figurën më poshtë:

Fig. 6 - Krahasim i shkeljeve të konstatuara nga KLD në vitet 2014 - 2015



Nga grafiku i mësipërm rezulton se, në ndryshim nga viti 2014, gjatë vitit 2015 nuk janë trajtuar raste kur gjyqtarët kanë shkelur Vendimet Unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në raportin për vitin 2014, Res Publica rekomandoi që moszbatimi i vendimeve unifikuese nuk duhet të përbënte domosdoshmërisht shkelje për t'u pasuar me përgjegjësi disiplinore, nëse vendimi i gjyqtarit nën procedim ka qenë i arsyetuar dhe i mbështetur në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Një shembull tipik është ai i Vendimit Unifikues nr. 32/2003 të Gjykatës së Lartë që sanksionon mohimin e mbrojtjes gjyqësore për rikthimin në punë të disa kategorive të punonjësve të administratës shtetërore. Ky vendim unifikues, ndonëse ende në fuqi, nuk është zbatuar në shumë raste nga gjykata civile dhe më pas ajo administrative, pasi çështja bazë e GJENDNJ, Pellegrin kundër Francës, është ndryshuar nga vetë GJEDNJ më pas, në çështjen Eskelinen kundër Finlandës. “Testi Eskelinen” është i njohur në shumë çështje edhe kundër Shqipërisë në GJEDNJ dhe zbatimi i verbër i Vendimit Unifikues nr. 32/2003 i Gjykatës së Lartë është i gabuar. Në këto raste, gjyqtari që mbron një ide të kundërt me atë të shprehur në vendimin unifikues, duhet t’i jepet mundësia të ndryshojë praktikën për një respektim më të mirë të të drejtave të njeriut. Praktika, sipas së cilës, gjyqtari penalizohet në rast të moszbatimit të vendimeve unifikuese ka bërë që gjyqtarët të mos i vënë më në diskutim vendimet unifikuese edhe nëse ata janë të gabuar. Kjo mund të shpjegojë faktin se gjatë vitit 2015 mungojnë shqyrtimet nga KLD për këtë shkelje specifike.

#### 5.4. Kërkesa të depozituara nga Ministri i Drejtësisë për vitin 2015

Sic u përmend edhe më lart, KLD gjatë vitit 2015 ka shqyrtuar kërkesat për procedim disiplinor të depozituara nga Ministri i Drejtësisë gjatë vitit 2014, ndërsa në lidhje me kërkesat e depozituara për vitin 2015, sipas Ministrisë, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2015 janë nisur 16 kërkesa për procedim, nga të cilat:

- Në 13 raste është propozuar masa disiplinore “shkarkim nga detyra”
- Në 2 raste është propozuar masa disiplinore “vërejtje me paralajmërim”
- Në 1 rast është propozuar masa disiplinore “ulje në detyrë “1-2 vjet”

Nga këto kërkesa, KLD ka shqyrtuar vetëm njërën prej tyre, më anën e së cilës është kërkuar “shkarkimi nga detyra” i gjyqtarit. Në përfundim KLD ka vendosur rrëzimin e kërkesës si joproportionale me shkeljen e kryer dhe marjen e masës disiplinore “vërejtje me paralajmërim”.

Sa më sipër konstatohet një vonesë shumë e madhe në shqyrtimin e kërkesave për procedim disiplinor, duke sjellë mbajtjen nën tension të gjyqtarëve që procedohen, gjë që mund të ketë efekte negative në dëm të interesave të palëve në gjykim.

### 5.5. Mosveprimi i Ministrisë së Drejtësisë

Në raportin për vitin 2014, Res Publica ka ngritur një shqetësim në lidhje me mos veprimin e Ministrit të Drejtësisë dhe kalimin e afateve për nisjen e procedimit disiplinor. Gjatë prezantimit të studimit në Maj 2015, ky konstatim u konfirmua dhe nga përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë në takim, duke pranuar se për dy raste është konstatuar që kanë humbur dokumentat dhe për këtë arsye nga Ministri i Drejtësisë është bërë kallzim penal në Prokurorinë e Rrethit Tiranë.

Res Publica kërkoi informacion në rrugë zyrtare nga Ministria e Drejtësisë në lidhje me fazën ku ndodhej hetimi dhe çfarë kishte vendosur eventualisht Prokuroria e Rrethit Tiranë. Nga përgjigjia rezultoi se Prokuroria ka vendosur pushimin e çështjes me arsyetimin e mëposhtëm:

*“Organi procedues në analizë të faktit dhe të provave të administruara çmon se fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale. Nga ana e inspektorëve të Ministrit të Drejtësisë rezultoi të jenë kryer të gjitha veprimet për çështjet që i janë ngarkuar për ndjekje, përfshirë njoftimin e gjyqtarëve dhe përpilimin e Memore drejtuar Ministrit të Drejtësisë...Neni 34 i ligjit 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se: “Të drejtën për nisjen e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë e ka Ministri i Drejtësisë. Ky përcaktim lë në diskrecion të plotë të autoritetit të Ministrit të Drejtësisë nisjen ose jo të procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Në këto rrethana kjo kompetencë e Ministrit të Drejtësisë, e shprehur në mos nisjen e një procedimi disiplinor ndaj një gjyqtari, nuk pasjell në asnjë rast përgjegjësi penale.”*

Nga sa më sipër rezultoi se, sipas Prokurorisë së Rrethit Tiranë, nga ana e Ministrit të Drejtësisë nuk është nisur kërkesa për procedim disiplinor dhe se mosveprimi i Ministrit nuk e ngarkon këtë të fundit me përgjegjësi penale, pasi është tërësisht në diskrecionin e tij të nisë ose jo një procedim disiplinor ndaj gjyqtarëve. Sipas Prokurorisë dosjet nuk kanë humbur dhe si pasojë ngrihen dyshime që procedimi disiplinor nuk ka nisur për mungesë të vullnetit të Ministrit të Drejtësisë.

Mosveprimi i Ministrit, duke lënë që të kalojë afati 1 vjeçar, është konstatuar edhe nga KLD gjatë një vendimarrje të saj (shih Vendimin nr.22, datë 03.03.2015).

Lidhur me sa më sipër, ngrihet një shqetësim i madh që nëse Ministri i Drejtësisë nuk dëshiron të nisë procedimin disiplinor, atëherë ai nuk do të ketë asnjë përgjegjësi penale, pavarësisht sa e rëndë mund të jetë shkelja e kryer nga gjyqtari që i shpëton procedimit disiplinor, siç ka ndodhur disa herë gjatë viteve 2014 – 2015. Gjithashtu, mosveprimi i Ministrit të Drejtësisë krijon premisat që gjyqtarët që janë konstatuar me shkelje të mbeten në varësi të humorit të Ministrit, i cili ka diskrecion të plotë mbi fatin e tyre, duke cenuar kështu pavarësinë e gjyqësorit.

## 5.6. Imuniteti ndaj procedimit disiplinor i gjyqtarëve, anëtarë të Kolegjit Zgjedhor

Një problem shqetësues që është konstatuar edhe nga vetë KLD gjatë mbledhjeve të saj në vitin 2015 është pa mundësia e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve që janë anëtarë të Kolegjit Zgjedhor. Kjo pamundësi vjen për shkak të parashikimeve ligjore që ndalojnë në mënyrë taksative çdo lloj procedimi kundër një anëtari të Kolegjit Zgjedhor. Konkretisht në nenin 149 të Kodit Zgjedhor parashikohet se:

*“Gjyqtari i Kolegjit Zgjedhor nuk mund t’i nënshtrohet procedimit disiplinor gjatë gjithë periudhës për të cilën është krijuar kolegji.*

*Gjatë kësaj kohe, gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë nuk mund të lëvizën nga detyra e gjyqtarit, për shkaqe që lidhen me nenin 32 të ligjit nr. 9877 datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe për pamjaftueshmëri profesionale. Ndaj tyre nuk mund të jepet vlerësimi “i paaftë”.*

Qëllimi i parashikimit të dispozitës së mësipërme është mbrojtja e gjyqtarit nga çdo lloj ndikimi të jashtëm. Por, në rastet kur kjo “mbrojtje” kthehet në një abuzim nga ana e gjyqtarit, i cili nën këtë mburojë shkel ligjin dhe të drejtat e palëve në proces, kjo dispozitë e humbet qëllimin për të cilën është krijuar. Arsyetimi dhe dorëzimi, siç ka pasur raste, i 40% të vendimeve me vonesë, është një shkelje e rëndë nga ana e gjyqtarit dhe ai nuk mund të shpëtojë nga procedimi disiplinor, për shkak të ekzistencës së kësaj mburoje ligjore. Duhet të theksojmë që afati i mandatit të anëtarit të Kolegjit Zgjedhor është 4 vjet, brenda së cilës gjyqtarët, anëtarë të Kolegjit Zgjedhor, kanë imunitet ndaj procedimeve disiplinore. Kujtojmë se afati maksimal për të proceduar për një shkelje të kryer nga gjyqtari është 5 vjet nga momenti i kryerjes së shkeljes. Në këtë mënyrë, edhe nëse gjyqtari do të inspektohet menjëherë pas mbarimit të mandatit si anëtar i Kolegjit Zgjedhor, ai nuk do të përgjigjet për shkeljet e kryera deri 1 vit para nisjes së këtij mandati, si dhe, nëse inspektimi nuk do të nisë menjëherë pas mbarimit të mandatit, ai nuk do të përgjigjet edhe për shkelje të kryera gjatë mandatit.

Në vijim jepet një rast për të ilustruar sa më sipër.

### Shembull 4 - Procesverbali i datës 22.12.2015

*Kryetari i Gjykatës së Apelit Tiranë ka informuar periodikisht në fakt, sikundër të gjithë kryetarët, që nga viti 2012, në fund të vitit 2012 e deri aktualisht (informon) dhe një pjesë e informacionit të tij lidhet me vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Ka informuar muaj për muaj për vonesat, ndër të cilat, rast i përsëritur ka qenë nga gjyqtarja E.P. Në këtë informacion e kemi përpunuar. Ka një problem tek Kodi Zgjedhor i cili parashikon që meqenëse gjyqtarja në fjalë është anëtare e Kolegjit Zgjedhor, ajo ka imunitet nga procedimi disiplinor (neni 149 i Kodit Zgjedhor). Ndërkohë, kryetari i gjykatës ka paraqitur informacionin e fundit shtesë, të cilin jua ka drejtuar edhe juve në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, por e ka sjellë edhe këtu në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, dhe e shtrinë informacionin e tij, tashmë jo për 1 muaj por për një periudhë disavejçare dhe thotë që ka nxjerrë të dhënat nga të cilat evidentohet që gjyqtarja Edlira Petri ka dhënë në vitin 2013, në vitin 2014, në vitin 2015, ka dhënë vendime të cilat janë arsyetuar me vonesë prej saj. Konkretisht informacioni i referohet saktësisht periudhës dhjetor 2011 – shtator 2015, dhe sipas kryetarit ajo ka dhënë 644 vendime gjyqësore për çështjet civile dhe masa sigurimi personal nga të cilat 293 vendime civile janë arsyetuar dhe dorëzuar përtej afatit ligjor, pra rreth 40% e vendimeve. Kjo është një çështje shqetësuese në opinion tonë. Analiza paraprake që i ka bërë Inspektorati ju është bashkëngjitur materialit në mbledhje dhe është përfshirë për diskutim në mbledhje të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*

Në lidhje me sa më sipër nevojitet rishikimi i imunitetit që kanë anëtarët e Kolegjit Zgjedhor, duke përfshirë në mënyrë specifike rastet dhe mënyrën e procedimit të tyre, në një mënyrë të përshtatshme.

### 5.7. Refuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive

Një nga shkeljet që konsiderohet shumë e rëndë sipas nenit 32/ç të ligjit nr. 9877/2008 është refuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive. Masa disiplinore që merret në këtë rast është “shkarkim nga detyra”. Ky fakt, që përbën shkak për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit, parashikohet edhe si vepër penale nga Kodi Penal, duke sjellë konfuzion në veprimtarinë e KLD-së, në rastin e shqyrtimit të masës disiplinore me këtë motivacion, krahas ndjekjes penale.

Nga monitorimi ka rezultuar që për vitin 2015, janë proceduar penalisht 3 gjyqtarë me akuzën e deklarin të rremë të pasurisë. Për dy prej tyre është kërkuar pezullimi i ushtrimit të detyrës, i cili u pranuar nga KLD, ndërsa për një tjetër është nisur procedimi disiplinor për “shkarkim nga detyra”. Për këtë rast KLD ka vendosur pezullimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor derisa të shprehet gjykata me një vendim të formës së prerë. Pezullimi i procedimit është një procedurë e re, e zbatuar nga KLD-ja për herë të parë, duke u shoqëruar me diskutime të shumta në rradhët e vetë anëtarëve të KLD-së.

#### Shembulli 5 - Procesverbali datë 15.01.2016

*Ministri i Drejtësisë: ...më lejoni t'ju kujtoj që Ministri i Drejtësisë i propozon Këshillit të Lartë të Drejtësisë largimin e kësaj gjyqtareje për akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë figurën dhe pozitën e gjyqtarit. Ministri i Drejtësisë nuk ka ardhur në Këshillin e Lartë të Drejtësisë që t'u thotë, -hajde ta fusim në burg apo ta nxjerrim nga burgu këtë gjyqtare. Jo, po ju thotë, për shkak të veprimtarisë që është konfirmuar nga një institucion i padiskutueshëm, se s'kemi një institucion të dytë që ta bëjë këtë punë (ILDKP), nuk ka një të dytë shteti shqiptar. Atë ka. Na ka konfirmuar me shkrim dhe zyrtarisht që kjo zonjë ka fshehur pasuri, ka bërë deklarin të rremë, etj., etj. Pra është një listë e gjatë shkeljesh. Pra shkeljet çojnë tek aktet dhe sjelljet. Nëse gjykohet fajësia apo pafajësia e zonjës, ka të bëjë me kriterin tjetër, kryerjen e një krimi ose jo. Kështu që nga kjo pikëpamje, konkurrenca ndërmjet të dy ngjarjeve, që janë edhe mosmarrëveshje, është legjitime. Pra ne nuk po themi që kjo të shkarkohet për kryerjen e një krimi. Kjo do kishte sens që ne ta presim Prokurorinë dhe të themi që u gjykua e fajshme apo e pafajshme. Këtu po flasim që, me kaq sa ka ndodhur, është cenuar rëndë figura e gjyqtarit. Kjo është ftesa e ministrit të Drejtësisë, ky është propozimi i ministrit të Drejtësisë. Dhe ju lutem, ju ftoj që ta mendojmë kështu. Pastaj, a ka element mbi këtë, pra mbi cenimin e figurës së gjyqtarit, a ka element që vërtetojnë fajësinë penale, është çështje tjetër.*

*A.Broci: Në këto kushte unë do të isha që të ishte në të njëjtin rast, që procedimi disiplinor nuk mund të vazhdojë, për shkak se nuk kemi të provuar fajësinë për gjyqtaren. Kështu që, të mbarojë çështja penale dhe më pas ne këtu jemi, të shprehemi për këtë rast. Do ishte një propozim alternativ me kërkesën e ministrit, para se te futet në votim.*

*S. Çomo: Ose të vijmë tek procesi administrativ, është njësoj që ne të themi që shiko, meqenëse nuk e ka gjobitur Inspektorati, ne u bindëm nga verifikimi ynë që ai i ka fshehur, por meqenëse nuk e gjobiti Inspektorati, unë do vazhdoj ta mbaj gjyqtar këtë, meqenëse nuk i dha gjobë Inspektorati. Prandaj them që këto janë të ndara dhe ne këtu jemi, ka apo jo në veprimet e gjyqtarit arsye që ne ta trajtojmë sipas ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” dhe sipas ligjit “Për organizimin dhe funksionimin*



*e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”. Unë jam i mendimit që për sa kohë, së më tepër nuk ka dhe një çështje penale, nuk ka asnjë arsye për të diskutuar sepse ne po diskutojmë mbi hipotezën, “po meqë ka një kallëzim” “po ta pezullojmë ne këtë” “se mos ai kallëzimi kthehet në çfarë”... që s’e gjejmë dot sot, se s’mund ta gjejmë. Nuk e di avokati i gjyqtarës e jo më ta dimë ne hipotezën se çfarë do ndodhi me kallëzimin. Kështu që unë ngelem tek propozimi i ministrit. Ne kemi për detyrë t’i japim përgjigje këtij procedimi. Unë ndahem tek mënyra e të proceduarit dhe e të verifikuarit të fakteve*

*E.Civici: Atëherë unë isha kundër edhe me propozimin për pezullim sepse jam e mendimit që kërkesës duhet t’i jepej shpjegim sot mbi bazën e materialeve që ka në dosje pikërisht për arsyet që kam shpjeguar më lart. Pra, nuk ka nevojë të pritët hetimi për efekt të shqyrtimit të kërkesës por kërkesa fare mirë mund të ishte marrë me materialet që s’janë të plota dhe të vendosej mbi të. **Në rastin e pezullimit të vendimit të KLD-së për të pritur çështjen penale, nuk e njeh ligji.** Ne duhet të shpreheshim për kërkesën kështu siç ishte dhe pastaj të vendosnim nëse ajo ishte e bazuar në ligj apo jo...*


Nga një vështrim krahasues me monitorimin e një viti më parë, rezulton që për vitin 2014 janë zhvilluar procedime disiplinore për 3 gjyqtarë për shkak të deklarimit të rremë të pasurisë, por kërkesa e Ministrit është rrëzuar për shkak se nuk ka pasur prova të mjaftueshme për vërtetimin e “akuzës” së ngritur (kërkesa nuk shoqërohej së bashku me deklaratimet e pasurisë). Ndryshe nga vendimarrja e mësipërme e KLD-së ku është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor, në 3 rastet e vitit 2014 është vendosur rrëzimi i kërkesës.

Edhe nëse do të biem dakort me interpretimin e KLD-së që duke qenë se deklarimi i rremë i pasurisë përbën veprë penale dhe duhet të qendrohet në pritje të një vendimi gjykatë, KLD-ja minimalisht duhet të pezullonte gjyqtarin nga detyra gjatë kësaj kohe, siç ka vepruar dhe në 2 rastet e tjerë të vitit 2015, dhe jo të vendoste pezullimin e procedimit me pasojë vijimin e ushtrimit të detyrës nga gjyqtari.

### 5.8. Mosrespektimi i afatit të shqyrtimit nga KLD

Në ndryshimet e bëra në vitin 2014 në Ligjin nr.8811/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, është parashikuar se shqyrtimi i procedimit disiplinor nga KLD-ja bëhet brenda një muaji nga data e depozitimit të dokumentacionit përkatës nga Ministri i Drejtësisë pranë KLD. Nga monitorimi është konstatuar se në asnjë rast ky afat ligjor nuk është respektuar.

**Fig. 7 - Afati i shqyrtimit të procedimeve disiplinore nga KLD për vitin 2015**



## 6. RAPORTI I INSTITUCIONEVE TE TJERA ME KLD


### 6.1. Inspektoriati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë

Nga përgjigjia zyrtare e vënë në dispozicion nga Inspektoriati i KLD rezulton që për periudhën Janar-Dhjetor 2015 ky inspektoriat i ka përcjellë Ministrisë së Drejtësisë 7 kërkesa për procedim disiplinor ndaj 7 gjyqtarëve, nga të cilat për 2 gjyqtarë Ministri i Drejtësisë ka vlerësuar mosfillimin e procedimit disiplinor, ndërsa për 5 rastet e tjera, shqyrtimi është në proces.

Pranë KLD-së, për vitin 2015 janë paraqitur 809 ankesa, nga të cilat ka dalë urdhër verifikimi në 176 raste, nga të cilët:

- 47 raste kanë për objekt mosrespektimin formal të ligjit;
- 32 raste kanë si objekt shkeljen e etikës;
- 66 raste janë për zvarritje të gjykimit;
- 31 rastet e tjerë referojnë në mos përdorimin e sistemit audio në seanca, shkelje procedural, etj.

Fig. 8 - Numri i ankesave, verifikimeve dhe raportimeve nga Inspektoriati i KLD-së



Nga grafiku i mësipërm rezulton se numri i ankesave për vitin 2015 ka pësuar një rënie të lehtë, e reflektuar kjo me një rënie pak më të madhe të numrit të verifikimit të ankesave nga ana e Inspektoriatit të KLD (nga 23.4% në 21.8%). Rënie më e fortë shënohet në rastet e raportuara, të cilat për vitin 2015 janë mbi 3 herë më të pakta në krahasim me vitin 2014. Ministri i Drejtësisë nuk i ka dërguar të gjithë rastet e raportuar në KLD, duke marrë vendim për të mos nisur procedimin disiplinor. Informacioni për këtë vendimmarrje është bërë i ditur nga Inspektoriati i KLD-së vetëm pas përpunimit të të dhënave statistikore të vitit 2015 dhe ende nuk është e qartë se cilat kanë qenë arsyet e vendimmarrjes së Ministrit të Drejtësisë për 2 rastet e mosfillimit të procedimit.

## 6.2 Avokati i Popullit

Res Publica ka kërkuar informacion zyrtar edhe nga Avokati i Popullit për numrin e rasteve të dërguara nga ky institucion, Inspektoriatit të Ministrisë së Drejtësisë dhe Inspektoriatit të KLD-së dhe cilat janë vendimmarrjet e tyre mbi këto raste.

Nga përgjigja zyrtare rezulton se gjatë vitit 2015, Avokati i Popullit ka trajtuar 6 ankesa, kryesisht të përqendruara tek shkelja e ligjit nga ana e gjyqtarit. Ato i janë dërguar Inspektoriatit të KLD-së për verifikim dhe në bazë të Memorandumit, Inspektoriati i ka komunikuar Avokatit të Popullit se për kërkesat e dërguara:

- 2 raste janë arkivuar, pasi ka kaluar afati 5 vjeçar, brenda të cilit duhet të përfundojë një procedim disiplinor sipas ligjit;
- 1 rast është në proces, pasi pritet të përfundohet çështja në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec;
- 1 rast është arkivuar, pasi pretendimi i ngritur mund të zgjidhet nga gjykatat më të larta;
- 1 rast është në proces verifikimi;
- 1 rast është konstatuar shkelja, por kjo do të mbahet në konsideratë për efekt të Vlerësimit Profesional dhe Etik të gjyqtarit.

Bazuar në informacionet e marra nga Avokati i Popullit, rezulton se për vitin 2015 janë shtuar ankesat, gjithsej 6 të tilla, krahasuar me vitin 2014, ku numri i tyre ishte 3. Por, duhet theksuar se në dy prej tyre, afati i parashkrimit prej 5 vjetësh nga momenti i kryerjes së shkeljes, kishte kaluar, duke e bërë ankesën e Avokatit të Popullit joefektive.



## 7. TRANSPARENCA E KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Transparenca e KLD është përmirësuar ndjeshëm në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014. Gjatë monitorimit të faqes së internetit të KLD-së, për vitin 2015 konstatohet se vendimet janë publikuar plotësisht, përfshirë edhe të gjithë procesverbalet e mbledhjeve. Ndaj kërkesave për informacion KLD është përgjigjur rregullisht.

Në faqen e internetit gjendet edhe rubrika “Programi i transparencës”, i cili është pjesërisht i plotësuar, por në një gjendje relativisht të mirë krahasuar me autoritete të tjerë publikë<sup>19</sup>. Gjithashtu, konstatohet se faja web e KLD-së përmban edhe disa rubrika të tjera të vlefshme për ankesat online, shpjegime për ecurinë e ankesave, etj., të cilat janë mjaftueshëm orientuese për personat e interesuar.

Faja web është konstatuar se përditësohet relativisht shpejt, duke dhënë informacione pa vonesë për publikun dhe mediat.



## 8. KONKLUZIONE & REKOMANDIME

### 8.1. Konkluzione

1. Një problem që konstatohet edhe gjatë vitit 2015 është mosveprimi i Ministrit të Drejtësisë brenda afatit, duke sjellë në një rast pandëshkueshmërinë e gjyqtarit, për të cilin ishte konstatuar se kishte kryer shkelje. Mosveprimi i Ministrit të Drejtësisë për nisjen e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve të konstatuar si shkelës të ligjit ose etikës, me pasojë pandëshkueshmërinë e tyre, nuk pasohet me asnjë lloj përgjegjësie ligjore në ngarkim të Ministrit të Drejtësisë.
2. Ministri i Drejtësisë, në cilësinë e organit që ka kompetencën ekskluzive për nisjen e procedimit disiplinor, ka diskrecion në propozimin e masës, ndryshimin e saj para dhe gjatë shqyrtimit nga KLD, por vihet re se ai nuk arsyeton këto vendimmarrje, sidomos në rastet kur ndryshon masën e propozuar.
3. Konstatohet se Ministri i Drejtësisë në 2 raste ka vendosur mosfillimin e procedimit disiplinor, pa bërë publike arsyet e këtyre vendimeve.
4. Një problem tjetër i konstatuar gjatë vitit 2015 është pandëshkueshmëria e gjyqtarëve që janë anëtarë të Kolegjit Zgjedhor, për shkak të imunitetit që ata gëzojnë në bazë të Kodit Zgjedhor.
5. Konstatohet se është ulur numri i përgjithshëm i ankesave ndaj gjyqtarëve, si dhe verifikimet e këtyre ankesave nga Inspektoriati i KLD-së. Vihet re një rënie 3 herë më e madhe të rasteve të raportuara nga ky inspektoriat te Ministri i Drejtësisë.
6. Gjatë vitit 2015, numri i shqyrtimit të procedimeve disiplinore për gjyqtarët nga ana e KLD ka qenë afro dy herë më i vogël se numri i procedimeve të shqyrtuara në vitin 2014.
7. Një masë e madhe prej 15 rastesh të dërguara nga Ministri i Drejtësisë gjatë vitit 2015 janë mbartur për t'u shqyrtuar gjatë vitit 2016. Konstatohet se në të gjithë rastet nuk është respektuar afati ligjor prej 1 muaji për përfundimin e procedimit disiplinor. Vonesa në shqyrtimin e kërkesave, dhe në përgjithësi kohëzgjatja e shqyrtimit të procedimit disiplinor, i mban gjyqtarët nën tryzni, e cila cenon pavarësinë dhe paanësinë e gjykatës, në dëm të palëve në proces.

8. Konstatohet se përputhja mes propozimeve të Ministrit të Drejtësisë dhe vendimeve të KLD-së ndodh vetëm në 1/3 e rasteve. Në rastet e tjerë vendimet ose ndryshojnë, ose rrëzojnë propozimet e Ministrit.
9. Gjatë vitit 2015 kërkesat e Ministrit të Drejtësisë janë pranuar në një masë më të madhe, në krahasim me vitin 2014, për arsye se propozimet janë shoqëruar me provat përkatëse.
10. Gjatë 2015 vihet re një rritje e ndjeshme e rasteve të pezullimit të gjyqtarëve, autorizimit për masat e arrestit ndaj tyre, si dhe shkarkimin e tyre për shkak të një vendimi penal.
11. Ndryshimet ligjore të bëra në vitin 2014 kanë sjellë efekte pozitive, pasi propozimi i një mase joproporcionale nga Ministri i Drejtësisë nuk rrëzohet nga KLD, por kjo e fundit e zëvendëson atë me një masë më proporcionale, duke shmangur pandëshkueshmërinë e gjyqtarëve që kryejnë shkelje të ligjit dhe etikës.
12. Gjatë vitit 2015, llojet e masave disiplinore të propozuara dhe të dhëna janë kufizuar vetëm në dy të tilla, në ndryshim nga viti 2014 kur masat kanë qenë më të larmishme.
13. Gjatë vitit 2015 nuk është konstatuar asnjë rast kur procedimi disiplinor ka nisur për shkak të moszbatimit të vendimeve unifikuese, duke dëshmuar që gjyqtarët kanë qenë më të kujdesshëm në zbatimin e tyre.
14. Transparenca e KLD është përmirësuar ndjeshëm në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014. Gjatë monitorimit të faqes së internetit të KLD-së, për vitin 2015 konstatohet se vendimet janë publikuar plotësisht, përfshirë edhe të gjithë procesverbalet e mbledhjeve. Ndaj kërkesave për informacion KLD është përgjigjur rregullisht.

## 8.2. Rekomandime

Krahas rekomandimeve të paraqitura në studimin e bërë nga Res Publica për veprimtarinë e KLD-së për vitin 2014 (publikuar në Maj 2015), të cilët nuk janë reflektuar ende, bazuar në konkluzionet për vitin 2015, Res Publica paraqet rekomandimet e mëposhtme:

### Rekomandimi nr. 1

**Nisja e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve të mos jetë kompetencë ekskluzive e Ministrit të Drejtësisë**

Rekomandojmë që nisja e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve të mos jetë kompetencë ekskluzive e Ministrit të Drejtësisë, por kjo kompetencë t'i jepet edhe aktorëve të tjerë të sistemit të drejtësisë (për shembull: kryetarët e gjykatave, çdo anëtar i KLD-së, etj.)

### Rekomandimi nr. 2

**Nëse kompetenca për nisjen e procedimit disiplinor do të jetë vetëm e Ministrit të Drejtësisë, ky i fundit duhet ta ketë detyrim ligjor**

Në alternativë të Rekomandimit nr. 1, nëse kompetenca për nisjen e procedimit disiplinor do të vijojë të jetë vetëm e Ministrit të Drejtësisë, ky i fundit duhet ta ketë detyrim

ligjor, mosrespektimi i të cilit të përbëjë mospërbushje të rregullt të detyrës, me pasojë përgjegjësinë penale.

### **Rekomandimi nr. 3**

**Ministri i Drejtësisë të arsyetojë vendimet për ndryshimin e masave disiplinore dhe mosfillimin e procedimit disiplinor**

Ministri i Drejtësisë duhet të arsyetojë vendimet për ndryshimin e masave disiplinore para dhe gjatë shqyrtimit nga KLD, si dhe kur vendos mosfillimin e procedimit disiplinor. Ndaj këtij vendimi duhet të parashikohet e drejta e ankimit të Inspektoriatit të KLD-së, në rastet kur propozimi vjen nga ky organ.

### **Rekomandimi nr. 4**

**Të ndryshohet Kodi Zgjedhor në mënyrë që të parashikohen në mënyrë specifike rastet dhe mënyra e procedimit të gjyqtarëve, anëtarë të Kolegjit Zgjedhor**

Rekomandohet të ndryshohet Kodi Zgjedhor në pjesën që parashikon imunitet për anëtarët e Kolegjit Zgjedhor, në mënyrë që të parashikohen në mënyrë specifike rastet dhe mënyra e procedimit të gjyqtarëve që janë anëtarë të Kolegjit Zgjedhor.

### **Rekomandimi nr. 5**

**Të merren masa që KLD të respektojë afatin 1 mujor, brenda të cilit KLD duhet të përfundojë shqyrtimin**

KLD duhet të marrë masa që shqyrtimi i kërkesave për procedim disiplinor të përmbyllet brenda afatit ligjor prej 1 muaji, për të realizuar ndëshkimin e gjyqtarëve në kohën e duhur, ose çlirimin e tyre nga barra e një procedimi, nëse ai është i pambështetur në prova, për të respektuar pavarësinë e gjyqsorit, në emër të interesit të palëve në proceset që shqyrtohen nga ai gjyqtar.


\* \* \*

Tiranë, Mars 2016

Qendra “Res Publica”  
“Pandëshkueshmëria në procedimet disiplinore të  
gjqtarëve. Analizë e disa prej shkaqeve që stimulojnë  
pandëshkueshmërinë në veprimtarinë e KLD, për vitin 2015”  
Mbështetur nga:  
Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë  
Tiranë, Maj 2016  
36 faqe  
Format: 21 x 29.7 cm



[www.respublica.org.al](http://www.respublica.org.al)



**RESPUBLICA**